



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 64, paragrafi 1, pika 22 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 3/2002, 51/2003, 85/2003, 40/2004, 61/2005 dhe 129/2006) dhe nenit 172, paragrafët 1 dhe 8 të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2007), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori:

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 78/08)

I. Në Vendimin për kushtet dhe mënyrën e punës së kursimoreve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 79/2007), bëhen këto ndryshime dhe plotësime:

1. Në Kreun I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, pika 1, shtohet nënparagraf i ri i katërt si më poshtë:

"- auditim i brendshëm".

2. Pas kreut IV shtohet kreu i ri V, si më poshtë:

"V. AUDITIM I BRENDSHËM

9. 9. Për kursimoret zbatohen dispozitat për mënyrën e organizimit dhe të kryerjes së auditimit të brendshëm të kreut IX, pjesës 6 të Ligjit të Bankave.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, nëse kursimorja nuk ka person - auditor të autorizuar në Shërbimin e auditimit të brendshëm, organi mbikëqyrës ose Kuvendi, përkatësisht Kuvendi i ortakëve të kursimores, mund të angazhojë shoqëri auditimi ose person - auditor i autorizuar, për të siguruar vazhdimësinë e kryerjes së funksionit të auditimit të brendshëm, së bashku me personin/personat e punësuar në Shërbimin e auditimit të brendshëm.

Shoqëria, përkatësisht personi i paragrafit 2 të kësaj pike, është i detyruar t'i respektojë parimet dhe rregullat e auditimit të brendshëm, në përputhje me Ligjin e Bankave dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji.

Kursimorja mund të angazhojë shoqërinë e njëjtë për auditim ose person – auditor i autorizuar, për një periudhë të pandërprerë prej tre vjetësh.

Shoqëria, përkatësisht personi i paragrafit 2 të kësaj pike, gjatë periudhës sa është i angazhuar si auditor i autorizuar në kursimore, nuk mund të kryejë, përkatësisht të marrë pjesë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore të kursimores.

Kursimorja është e detyruar të sigurojë përcaktimin e saktë të dispozitave të kontratës me shoqërinë, përkatësisht personin e paragrafit 2 të kësaj pike, e cila do të mundësojë përcaktimin e qartë të të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet dy palëve, si dhe:

- klauzolën për mundësinë e përfundimit të parakohshëm të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale, me kërkesë të kursimores;
- dispozitat e mbrojtjes së fshehtësisë së të dhënave të kursimores;
- dispozitat e sigurimit të harmonizimit të shoqërisë, pra të personit me rregulloret përkatëse.

Kursimorja është e detyruar ta njoftojë BPRM për kushtet sipas të cilave është angazhuar shoqëria, përkatësisht personi i paragrafit 2 të këtij neni.”

3. Kreu V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE bëhet kreu VI, ndërsa pikat 9, 10 dhe 11 bëhen pikat 10, 11 dhe 12.

II. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

V nr. 02-15/VII-1/2008
26.6.2008
Shkup

Mr. Petar Goshev
guvernator dhe kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë